

SHËRBIM LIGJOR PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Shërbimi ligjor është pjesë e shërbimeve të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, të manaxhuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Si pjesë e shërbimit Help-Desk për OJF-të dhe grupimet informale të aktivistëve, shërbimi ligjor përfshin:

01 Informim dhe Edukim Ligjor për OJF-të

- Informacion mbi aksesin në institucionet e administratës publike, procedurat për akses efektiv nga ana e subjekteve OJF, afatet për kërkesa / aplikime e kthimin e përgjigjeve nga institucionet etj;
- Informacion mbi aksesin në sistemin gjyqësor të subjekteve OJF, organizimin e tij, shkallët e sistemit gjyqësor të cilave mund t'u drejtohesh për çështje që kanë të bëjnë me çështje të caktuara, udhëzime të përgjithshme për formalitet e kërkesave / kërkesë-padive, procedurat, etj.

02 Këshillim Ligjor në lidhje me krijimin, funksionimin, përputhshmërinë ligjore dhe fiskale, dhe çregjistrimin ligjor për OJF:

- Krijim dhe regjistrim i OJF-së, depozitime dhe përditësim aktesh të brendshme të OJF-së në Regjistrin e OJF-ve.
- Regjistrimi në zyrat rajonale tatimore, në seksionet e taksa-tatime pranë bashkive përkatëse dhe përditësim të dhënash.
- Licensimi i OJF-së dhe përditësim përkatëse.
- Regjistrim i pronarëve përfitues.
- Regjistrimi i pronësisë industriale të OJF-së.
- Regjimi tatimor për OJF-të (veprimtari jofitimprurëse jo-ekonomike dhe ekonomike) dhe këshillime ligjore përkatëse.
- Legjislacioni AML dhe CFT (kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit) i zbatueshëm për OJF-të.
- Detyrime të OJF-së për deklarime dhe raportime.
- OJF-të si punëdhënës dhe në marrëdhëniet me vullnetarët.
- Marrëdhënie kontraktore, përfshirë kontrata financimi.
- Çregjistrimi i OJF-së për shkak likujdimi vullnetar apo falimentim.

Çfarë nuk
përfshihet

Përpilimi i dokumenteve dhe përfaqësimet në organet e administratës shtetërore administrative dhe gjyqësore apo ADR nuk përfshihen në këtë shërbim.

OFRIMI I SHËRBIMIT

→ SI

Për të marrë shërbimin, ju duhet të plotësoni këtë [FORMULAR](#) në të cilin duhet specifikuar qartë pyetja/çështja për këshillim ligjor dhe ta dërgoni në adresën e emailit info@resourcecentre.al

Nëse kërkesa juaj klasifikohet brenda fushave të mësipërme të shërbimit, ju do të kontaktoheni nga stafi i Qendrës Burimore për datën dhe orën e takimit për vijimin e shërbimit ligjor.

→ KU

Shërbimi ligjor do të ofrohet online, për të siguruar akses më të gjerë dhe shërbim më të shpejtë për OJF-të. Takimet do të zhvillohen në platformën ZOOM, pas konfirmimit të kërkesës për shërbim ligjor nga stafi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

→ KUSH

Konsulenti ligjor i Partnerëve Shqipëri, me përvojë në të drejtën tregtare, ndihmë ligjore dhe sektorin jofitimprurës.

→ KUR

Takimet do të zhvillohen çdo të mërkurë, nga ora 14.00 në 17.00 dhe do të zgjasin jo më shumë se 30 minuta.



Shënim: Partnerët Shqipëri nëpërmjet Konsulentit Ligjor nuk janë përgjegjës për kompensim dëmi dhe/apo fitimi të munguar që mund t'i shkaktohen OJF për shkak të krijimit, funksionimit dhe daljes së tyre nga tregu, në shkelje të dispozitave ligjore përkatëse.

OJF që përfitojnë shërbimin ligjor të OJF-ve kanë lirinë të diskutojnë këshillat ligjore të dhëna me profesionistë ligjore të tjerë para se të zbatojnë këshillimet e dhëna nga Shërbimi Ligjor për OJF-të i Partnerëve Shqipëri; në këto raste, Konsulenti Ligjor është i/e gatshme për të shkëmbyer argumentet ligjore për çështjet në fjalë vetëm kur gjykohet e nevojshme nga vetë Konsulenti Ligjor. Shërbimi ligjor mundësohet me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Na Kontakttoni

Rruga e Elbasanit, Park Gate Building, kati 10-të,
Ap. 71 / 73, Kutia Postare 2418/1, 1010 Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355697889600 | 00355 42254881

Email: info@resourcecentre.al

Web: <https://resourcecentre.al>